



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

# PLANI I MARKETINGUT

## POST COVID-19

### (Korrik-Dhjetor)



Përgatiti:

Elvira DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme, FBK

15.06.2020, Prishtinë

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive
2. Hyrje
- 2.1 *Rreth Planit të Marketingut Post Covid-19*
3. Objektivat
4. Grupet e Interesit të FBK-së
5. Analiza SWOT
6. Strategjia
- 6.1 *Fuqizimi i brendit*
- 6.2 *Raporti me mediat*
- 6.3 *Rritja e numrit të sponsorëve*
- 6.4 *Bashkëpunimi me Federatat Nacionale*
- 6.5 *Forcimi i marrëdhënieve tona ndërkombëtare*
- 6.6 *Promovimi i Ligave të Kosovës*
- 6.7 *Krijimi i produkteve të reja*
7. Plani i Veprimit/ Kontrolli dhe Vlerësimi
8. Përmbledhje
9. Rekomandime

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Prej datës 31 mars kur edhe janë anuluar aktivitetet e para të FBK-së për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19 e deri te data 10 qershor kur janë anuluar aktivitetet e fundit të FBK-së për edicionin 2019/20, Federata e Basketbollit të Kosovës pothuajse çdo ditë të javës ka qenë e pranishme në mediat e shkruara dhe ato elektronike nëpërmjet paraqitjes apo deklaratave të Kryetarit të FBK-së, Sekretares së Përgjithshme dhe Drejtorit të Përfaqësueseve.

Qasja e mediave ndaj vendimeve të FBK-së për anulimin e garave ka qenë kryesisht e mirë, derisa ka pasur aty këtu reagime të klubeve dhe trajnerëve, e të cilat nuk kanë bërë ndonjë bujë të madhe.

FBK gjithashtu ka qenë e pranishme në media nëpërmjet deklaratave dhe intervistave të basketbollistëve/eve të saj, qofshin ata të Përfaqësueseve të Kosovës, apo basketbollistë/e të klubeve anëtare, të cilët e kanë përcjellur mesazhin motivues tek të gjithë për të qëndruar në shtëpi, e më vonë edhe për të filluar me stërvitje në shtëpi.

FBK ka qenë shumë aktive në publikimin e informatave të ndryshme në faqen e saj zyrtare, të cilat më pas mediat në vendin tonë i kanë publikuar, përderisa ka qenë edhe mjaft aktive në rrjetet e saj sociale nëpërmjet kampanjave të ndryshme motivuese kryesisht të nisura nga FIBA dhe FIBA Europe.

Qasja e FBK-së ndaj mediave dhe anasjelltas vlerësohet të ketë qenë mjaft pozitive gjatë këtyre muajve, andaj ky trend duhet të vazhdohet e pse jo edhe të thellohet edhe më shumë.

Një dozë të madhe ndihme i ka dhënë edhe fillimi i jetësimit të projektit të Ligës së Përbashkët, Kosovë – Shqipëri, e që mediat në vendin tonë e kanë mirëpritur dhe i kanë kushtuar hapësirë të madhe kësaj teme me rëndësi të madhe kombëtare.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 2. Hyrje

### 2.1 Rreth Planit të Marketingut Post Covid-19

Federata e Basketbollit të Kosovës e ka pasur Planin e saj të Marketingut 2020 në bazë të të cilit ka vepruar deri më 13 mars kur edhe janë pezulluar të gjitha aktivitetet sportive me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19, dhe kur është “izoluar” e gjitha bota për shkak të këtij virusi.

Federata e Basketbollit të Kosovës në Planin e saj të Marketingut Post COVID-19 nuk është se do të synoj shumë të ndryshojë në planin e saj të marketingut të hartuar në fund të vitit të kaluar dhe të miratuar në fillim të këtij viti nga Bordi dhe Kuvendi i FBK-së.

Ajo çfarë FBK do të synoj të ndryshojë në Planin e saj të Marketingut Post COVID-19 janë objektivat e marketingut të FBK-së të cilat do të kenë të bëjnë më shumë me tejkalimin e situatës së pandemisë dhe përforcimit të markës së FBK-së dhe projekteve të saj zhvillimore dhe atyre kombëtare.

Një plan efektiv i marketingut është thelbësor për të siguruar që Federata e Basketbollit e Kosovës dhe basketbolli kosovar të bëhen një qendër plot energji brenda bashkësisë sportive kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky pra është një element kryesor për të siguruar që sporti ynë të rritet.

Qasja jonë për një plan të suksesshëm të marketingut janë analiza, sondazhet e tregut, hulumtimi, monitorimi dhe vlerësimi.

Prandaj ne do të vazhdojmë planin tonë të marketingut duke bërë analizën e situatës dhe mjedisit dhe rishikimin e të gjitha aktiviteteve tona aktuale të marketingut.

Federata e Basketbollit të Kosovës ka filluar të ndryshojë të menduarit për marketingun, nga “një gjë e këndshme, në një domosdoshmëri brenda Federatës”.

Rëndësia e të paturit një Plan të Marketingut është natyrisht e pamohueshme.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Marketingu mund të ofrojë aq shumë për Federatën, por kjo mund të arrihet vetëm nëse punohet në mënyrë ekipore (Bordi + Komiteti Ekzekutiv + Grupet e Interesit).

Ne duhet ta kemi të qartë dhe duhet të mësohemi me faktin se më e rëndësishme është "se çfarë FBK-ja mund të ofrojë", sesa "çfarë FBK mund të marrë".

Ne duhet të fokusohemi në atë se "çfarë mund të bëjmë dhe me kë për të krijuar rezultatet më të mira".

Pra përqëndrimi ynë duhet të jetë paralelisht edhe në krijimin e vlerave tona të përbashkëta me sponsorët apo partnerët potencial.



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### 3. Objektivat

- ***FBK do të vazhdojë me modernizimin e faqes zyrtare dhe përcjelljes nga afër të vizitorëve të saj;***
- ***Do të synoj të vazhdoj që të jetë e pranishme çdo ditë në media;***
- ***Do të synoj të arrijë marrëveshje me kompaninë Gjirafa për krijimin e videove në ngjarje të rëndësishme për të rritur shikueshmërinë në YouTube dhe rrjetet sociale;***
- ***Përgatitja e një platforme për mediat sociale;***
- ***Do të vazhdojë me publikimin e Bulletinit Informativ të FBK-së çdo tre muaj për Grupet e Interesit të Federatës;***
- ***Kategorizimi i sponsorëve: Premium, i Artë dhe i Argjendtë;***
- ***Shitja e sekondavë në Art Motion;***
- ***Shitja e produkteve të Përfaqësueses A të Kosovës nëpërmjet faqes zyrtare të FBK-së;***
- ***Basketbolli 3x3 të përforcohet dhe të përdoret si promovion për FBK-në;***
- ***Rishikimi i marrëveshjeve/kontratave me sponsorët/partnerët aktual dhe përgatitja e një analize dhe vlerësimi për ta (sponsorët me cash dhe me shërbime);***
- ***Organizimi i aktiviteteve dhe kampanjave të përbashkëta me sponsorët dhe partnerët aktual;***
- ***Publikimi i artikujve për basketbollin kosovar edhe në mediat ndërkombëtare;***
- ***Përfshirja sa më e madhe e basketbollistëve të Përfaqësueses A të Kosovës në kampanjat e sponsorëve kyc të FBK-së;***

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- ***Shfrytëzimi i basketbollistëve vendor që luajnë në Kosovë dhe jashtë vendit si ambasadorë për promovimin e sportit të basketbollit;***
- ***Zgjerimi i kampanjës për masivizimin e basketbollit femëror “Her World, Her Rules”;***
- ***Rritja e numrit të sponsorëve (cash) në 3;***
- ***Rritja e numrit të sponsorëve (me shërbime) në 3;***
- ***Nënshkrimi i 2-3 marrëveshjeve bilaterale me Federatat Nacionale të Basketbollit;***

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

#### 4. Grupet e Interesit të FBK-së

- Basketbollistët/et;
- Klubet;
- Qeveria;
- Sponsorët;
- Partnerët;
- Donatorët;
- Komuniteti ndërkombëtar i basketbollit;
- Mediat;
- Shikuesit;



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 5. Analiza SWOT

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Pikët e forta</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Reputacioni i FBK-së brenda dhe jashtë vendit;</li><li>- Zyra Ekzekutive në rritje profesionale;</li><li>- Basketbolli, sport i popullarizuar në Kosovë;</li></ul>  | <p><b>Pikët e dobëta</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Mungesa e sponsorëve;</li><li>- Mungesa e departamentit të marketingut në zyre të FBK-së;</li><li>- Mungesa e të hyrave;</li><li>- Rënia e cilësisë në basketbollin kosovar;</li></ul> |
| <p><b>Mundësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligji për sponsorizim;</li><li>- Rregulloret e FBK-së;</li><li>- Rrjetet sociale, interneti dhe website;</li><li>- Përkrahja nga institucionet;</li><li>- Bashkëpunimi i mirë i FBK-së me FIBA-n;</li><li>- Bashkëpunim i mirë i FBK-së me Federatat tjera Nacionale;</li></ul> | <p><b>Kërcënimet</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Rritja e konkurrencës në raport me sportet tjera;</li><li>- Mos-sigurimi i sponsorëve në numër të mjaftueshëm;</li><li>- Mos-përkrahja nga institucionet;</li><li>- COVID-19;</li></ul>    |

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 6. Strategjia

### 6.1 Fuqizimi i brendit

- **Kontraktimi i një kompanie të marketingut për zhvillimin dhe fuqizimin e brendit të Federatës;**

- a) *Sigurimi i sponsorëve;*
- b) *Vazhdimi i rritjes së imazhit të Përfaqësueses A të Kosovës;*
- c) *Vazhdimi i rritjes së imazhit të Superligës së Kosovës;*
- d) *Rritja e imazhit të Superligës së Femrave;*
- e) *Rritja e imazhit të basketbollit femëror;*
- f) *Fuqizimi i partneritetit me sponsorët tanë aktual;*



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 6.2 Raporti me mediat

- Vazhdimi i thellimit të marrëdhënieve me mediat nacionale;
- Vazhdimi i fuqizimit të partneritetit me partnerin aktual medial, ArtMotion;
- Shfrytëzimi i faqes zyrtare të FBK-së për promovimin e basketbollit dhe FBK-së;
- Vazhdimi i përkthimit të lajmeve në faqen zyrtare të FBK-së në gjuhën angleze;
- Sigurimi i "highlights" për mediat kosovare nga ndeshjet e Superligës së Kosovës, Final 8 të Kupës së Kosovës, si dhe aktivitete tjera promovuese për FBK-në;

## 6.3 Rritja e numrit të sponsorëve

- Sigurimi i sponsorit gjeneral për Superligën e Kosovës;
- Sigurimi i sponsorit teknik për Përfaqësueset e Kosovës;
- Sigurimi i sponsorëve (afatgjatë) për Përfaqësueset e Reja të Kosovës;
- Sigurimi i partnershipit (afatgjatë) në projektet për zhvillim të gjeneratave të reja në FBK;

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

#### **6.4 Bashkëpunimi me Federatat Nacionale të Basketbollit**

- *Ofromi i njohurive, si dhe mbështetje të nevojshme për federatat nacionale që kanë nevojë për një gjë të tillë;*
- *Zhvillimi i projekteve të përbashkëta me Federatat tjera Nacionale të Basketbollit;*
- *Organizimi i seminareve për referë dhe trajnerë në Kosovë dhe dërgimi i ftesave për referët dhe trajnerët ndërkombëtar;*

#### **6.5 Forcimi i marrëdhënieve tona ndërkombëtare**

- *Pjesëmarrja në evente të organizuara nga FIBA dhe FIBA Evropa;*
- *Vizita të ndërsjella me zyrtarë të FIBA-s dhe FIBA Evropës;*
- *Vizita të ndërsjella me zyrtarë të Federatave të tjera Nacionale;*
- *Pjesëmarrja në seminare, klinika për trajnerë dhe referë që organizohen nga FIBA, FIBA Evropa dhe Federatat tjera Nacionale;*
- *Edukimi i stafit të FBK-së në programe të FIBA-s dhe FIBA Evropës;*

#### **6.6 Promovimi i Ligave të Kosovës**

- *Vazhdimi i përmirësimit të marrëdhënieve me klubet tona nëpërmjet takimeve më të shpeshta dhe projekteve të përbashkëta;*
- *Organizimi i seminareve për menaxhim dhe qeverisje të mirë për klubet tona;*
- *Asistimi i klubeve tona në realizimin e kërkesave të tyre kundrejt ministrisë apo institucioneve të tjera;*
- *Shpërblimi i klubeve për të arriturat e tyre brenda një edicioni;*

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 6.7 Krijimi i produkteve të reja

- *Hartimi i Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025;*
- *Zhvillimi i Mini-Basketbollit në Kosovë;*
- *Zhvillimi i basketbollit 3x3;*
- *Organizimi i turneve të basketbollit për vajza në bashkëpunim me shkollat fillore;*
- *Organizimi i një eventi brenda vitit për sponsorë – partnerë të FBK-së;*
- *Shfrytëzimi i basketbollistëve/eve (ambasadorë) në evente të ndryshme me FBK-në dhe me sponsorë/partnerë aktual dhe potencial;*
- *Promovimi i Ligës së Përbashkët (Kosovë-Shqipëri) nëpërmjet aktiviteteve të FBK-së;*



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

| <b>Veprimi<br/>(Çfarë)</b>                | <b>Detyra<br/>(Si)</b>                  | <b>Përgjegjësi<br/>(Kush)</b>   | <b>Afatet<br/>(Kur)</b> | <b>Burime</b>                              |
|---|---|---------------------------------|-------------------------|--|
| <i>Përgatitja e Planit të Marketingut</i> | <i>Pas diskutimeve me Bordin dhe KE</i> | <i>Sekretari i Përgjithshëm</i> | <i>Korrik – Dhjetor</i> | <i>FBK<br/>MKRS<br/>Sponsorët<br/>FIBA</i> |

## Kontrolli dhe Vlerësimi

| <b>Objektivat</b>                                 | <b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>                  | <b>Qëllimi</b>                                     | <b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>                  | <b>Frekuencat Kur</b>          | <b>Përgjegjës</b>   |
|---|---|--|---|--------------------------------|---|
| <i>Fuqizimi i FBK-së dhe basketbollit kosovar</i> | <i>FBK<br/>Zyra Ekzekutive<br/>Kompania e kontraktuar</i> | <i>Sigurimi i një stabiliteti financiar në FBK</i> | <i>Në bazë të analizave të bëra, hulumtimeve, raporteve</i> | <i>Në baza mujore, vjetore</i> | <i>Kryetari i FBK-së<br/>Bordi i FBK-së<br/>KE i FBK-së</i> |

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Rekomandime

Është e rëndësisë së veçantë që Bordi i FBK-së, Komiteti Ekzekutiv dhe Zyra Ekzekutive ta marrin seriozisht qasjen ndaj implementimit të këtij plani, sepse vetëm në këtë mënyrë të gjitha ato që janë shkruar në këtë plan mund të realizohen dhe në fund të vitit do të kemi një bilanc mes të asaj se a do të ishte më mirë të punojmë me një Plan të Marketingut apo pa të.

Federata e Basketbollit të Kosovës si institucion serioz dhe përgjegjësi kryesor për zhvillimin e basketbollit në vendin tonë, do të duhej të jetë si rol model në të ardhmen, jo vetëm për klubet dhe gjithë anëtarët e saj, por edhe për Federatat tjera sportive në vendin tonë.

Është e rëndësisë së veçantë që klubet e basketbollit dhe shkollat, apo shoqatat anëtare të saj të marrin shembull nga FBK, dhe në këtë mënyrë të vazhdojnë edhe ato me hartimin dhe implementimin e Planit të Marketingut.

## Përmbledhje

Ne besojmë fuqishëm se basketbolli është një platformë dhe nxitës për ndryshim. Çdo gjë që ne e bëjmë në Federatën e Basketbollit të Kosovës ka ndikim në mijëra njerëz, si dhe ka ndikim në zhvillimin e vendit tonë. Është përgjegjësia jonë për të vazhduar punën për rritjen e ndikimit të sportit tonë.

Promovimi dhe marketingu i sportit tonë është absolutisht thelbësor për rritjen dhe suksesin e qëndrueshëm.

Qasja jonë është bashkëpunuese dhe krijuese, si dhe do të sjellë përfitime për të gjithë komunitetin e basketbollit.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)

